



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizimi me pajisje për spërkatjen e pemëve

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës që posedojnë pemishte nga 0.10ha, që të përkrahen me pajisje për spërkatjen e pemëve, me kapacitet prej 60 litra mbushje.

Kriteret e përcaktuara :

- Përkrahen fermerët të cilët posedojnë pemishte ekzistuese, me sipërfaqe nga 0.10ha e më shumë;
- Fermerët me sipërfaqe më të madhe të mbjellë me pemë do të kenë përparësi;
- Përfituesit duhet të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe të kenë pronën në territorin e po kësaj komune;
- Përparësi do të kenë fermerët të cilët në 3 vitet e fundit nuk kanë qenë përfitues të projekteve nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Në kushte të barabarta, do të kenë përparësi banorët e zonave rurale;
- Pemishtja duhet të jetë e mirëmbajtur (masa ago-pomoteknike)

Dokumentacioni:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme;
- Kopja e planit;
- Vërtetimi i tatimit në pronë.

Data e aplikimit nga : 22.07.2019 deri më 09.08.2019